



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 750 Prot.

Tiranë, më datë 28.07.2020

VENDIM

Nr. 216, datë 21.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.07.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrje e vendimmarrjes për projektin “Restaurimi i 2 këmbëve të urës së Kalasë së Tepelenës dhe pjesa e pasarelës nën kala”, me hartues person i licencuar në restaurim Dhimitër Çondi dhe aplikues ARRSH;
- Të rishikohet projekti duke u mbështetur në projektin e hartuar nga specialistët e IMK-së (sot IKTK), të miratuar në KKR me Vendim Nr. 268, dt.31.05.2018;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

